



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0082
Data e Vendimit: 18.02.2025

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, si dhe nenit 17 paragrafi 6 i Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Doctor Exterminator” DDD SH.P.K kundër vendimit të AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit: “36 DDD objekteve të KPSH” me numër të prokurimit 616-24-9594-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Komuna e Prishtinës, U.D Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së, me datën: 18.02.2025, mori këtë:

Vendim

I. Hedhet si jo e plotë, ankesa e OE “Doctor Exterminator” DDD SH.P.K me nr. të protokollit 2025/0082, e datës 30.01.2025, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit: “36 DDD objekteve të KPSH” me numër të prokurimit 616-24-9594-2-2-1, i iniciuar nga Komuna e Prishtinës, në cilësi të AK-së.

II. I lejohet, Autoritetit Kontraktues- Komuna e Prishtinës që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “36 DDD objekteve të KPSH” me numër të prokurimit 616-24-9594-2-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

III Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale –

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 30.01.2025, ka pranuar ankesën e OE “Doctor Exterminator” DDD SH.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “36 DDD objekteve të KPSH” me numër të prokurimit 616-24-9594-2-2-1, i iniciuar nga Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoriteti Kontraktues.

Nga provat e administruara OSHP konstaton se me datën 26.12.2024, Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara. Poashtu me datën 06.01.2025, AK ka publikuar B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara. Hapja është planifikuar me date 16.01.2025 në 11:00

Me datën 20.01.2025 OE “Doctor Exterminator” DDD SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK e cila me datën 27.01.2025 ka publikuar vendimin lidhur me kërkesën për rishqyrtim.

Kundër vendimit të AK-së me datën 30.01.2025, OE “Doctor Exterminator” DDD SH.P.K ka parashtruar ankesë në OSHP Nr. 2025/0082 (Nr. protokolli)

- *Vlerësimi dhe administrimi i provave* –

Pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në këtë procedurë prokurimi nga zyra e pranimi në OSHP, është konstatuar njoftimi për kontratë 19.09.2024, afati për dorëzimin e tenderëve 06.01.2025 në ora 14:00. Afati për hapjen e tenderëve po i njëjti 06.01.2025 në ora 14:00 në platformë elektronike ndërsa ne dosjen e tenderit te korrigjuar me date 06.01.2025 hapja është me date 16.01.2025 në 11:00.

Me datën 27.01.2025, AK ka publikuar Njoftimin B58 për dhënie të kontratës.

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës është gjetur se parashtruesi nuk ka dorëzuar fare ofertë në këtë aktivitet të prokurimit dhe nuk është fare pjesë e këtij aktiviteti të prokurimit. Ky fakt nuk kontestohet as nga vet parashtruesi përmes kërkesës për rishqyrtim.

OSHP sqaron se konform nenit 33 të LPP-së, operatori ekonomik ka mundur të interesohej se a është bërë pranimi i ofertës së tij, duke qenë se ka pasur dijeni qe ka pasur probleme me sistemin e e-prokurimit, mirëpo këtë nuk e ka bërë dhe rrjedhimisht oferta e tij nuk është dorëzuar fare, andaj mbi bazën e kësaj OSHP sqaron se ankesa e dorëzuar në OSHP është jo e plotë (e palejuar) dhe si e tillë nuk shqyrtohet nga OSHP, ashtu siç është paraparë shqyrtimi sipas nenit 109 të LPP-së.

Mbi bazën e asaj që OE nuk ka dorëzuar fare ofertë, OSHP konsideron se i njëjti nuk është palë e interesuar në kuptim të nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP ku përcaktohet se "Palë e interesuar është personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar”.

Andaj, mbi bazën e të lartcekurave, OSHP konstaton se operatori ekonomik ka parashtruar ankesë jo të plotë siç parashihet me dispozitat e legjislacionit primar dhe sekondar dhe me Rregulloren e Punës së OSHP-së andaj ankesa e OE “Doctor Exterminator” DDD SH.P.K hedhet poshtë si jo e plotë (nuk shqyrtohet) dhe i lejohet autoritetit kontraktues – Komuna e Prishtinës, të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “36 DDD objekteve të KPSH” me numër të prokurimit 616-24-9594-2-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

UD. Udhëheqës i Sekretariatit, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Duke qene se OE ankues me rastin e parashtrimit te ankesës ka paguar tarife, e njëjta konform nenit 31, par 4 te Rregullores se Punës se OSHP-se, i kthehet OE ankues. I njëjti obligohet qe kërkesën për kthim te mjeteve ta parashtroje brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve sipas nenit 31 par 6 te rregullores se cituar me larte.



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: